

PHILIPS

NX0960



Manuali i përdorimit

Tabela e përmbajtjes

E rëndësishme	3
Fushat elektromagnetike (EMF)	5
Fikja automatike	5
Hyrje	6
Shikim i përgjithshëm	7
Përshkrimi i funksioneve	8
Përpara përdorimit të parë	10
Lidhja e fritezës me ajër me programin NutriU	11
Përgatitja për përdorim	13
Përdorimi i fritezës me ajër	13
Mënyrat e gatimit	16
Gatim i udhëzuar me recetë përmes programit NutriU	16
Modaliteti "Ingredients"	17
Modaliteti "cooking method"	22
Modaliteti "manual"	30
Aksesorët	31
Kontrolli me zë	32
Pastrimi	33
Të përgjithshme	33
Tabela e pastrimit	35
Përdorni programet e automatizuara të pastrimit	36
Vendruajtja	37
Riciklimi	37
Deklarata e konformitetit	38
Garancia dhe mbështetja	38
Përditësimet e softuerit dhe firmuerit	38
Përputhshmëria e pajisjes	38
Rikthimi në parametrat e fabrikës	38
Zgjidhja e problemeve	39

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë dokument informacioni të rëndësishëm përpara se ta vini në punë pajisjen dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhytni kurrë pajisjen në ujë dhe as mos e shpëlani në çezmë.
- Mos e mbushni folenë e gatimit me ujë pasi mund të shkaktojë elektroshok.
- Mos e mbushni folenë apo tiganin e gatimit me vaj pasi mund të përbëjë rrezik për zjarr.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Mos përdorni mjete të mprehta ose me gjemba për të pastruar grykën e ujit brenda folesë së gatimit, kjo mund të shkaktojë grykën.
- Mos i mbulonit vrimat e hyrjes dhe të daljes së ajrit ndërkohë që pajisja është duke punuar.
- Mos e prekni kurrë pjesën e brendshme të pajisjes ndërkohë që është duke punuar.
- Mos futni kurrë sasi më të madhe ushqimi sesa niveli MAX që tregohet tek aksesoret ose nëse cek kapakun.

Paralajmërim

- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", agjenti i tij i servisit apo persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangen rreziqet.
- Pajisjen lidhni vetëm me priza të tokëzuara. Sigurohuni gjithnjë që spina të futet siç duhet në prizë.
- Kjo pajisje nuk është menduar të vihet në përdorim me anë të një kohëmatësi të jashtëm apo një sistemi të veçantë për komandimin nga distanca.
- Sipërfaqet e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.



- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët, përveçse kur janë mbi 8 vjeç dhe nën mbikëqyrje.
- Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët më të vegjël se 8 vjeç.
- Mos përdorni kurrë përbërës me peshë të lehtë ose të ndezshëm, as letër pjekjeje në pajisje

- Mos e ekspozoni bazën e pajisjes ndaj temperaturave të larta, gazit të nxehtë, avullit apo lagështirës së nxehtë nga burime të tjera përveç vetë pajisjes me avull. Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë një stufe të nxehtë me gaz apo mbi të të gjitha llojet e stufave elektrike dhe pianurave elektrike ose në një furrë të nxehtë.
- Mos e vendosni pajisjen e ndezur përkundër një muri apo pajisjeve të tjera, as poshtë objekteve që mund të dëmtohen nga avulli, si muret dhe dollapët. Lini të paktën 10 cm hapësirë të lirë në pjesën e pasme, në të dyja anë e pajisjet dhe sipër saj. Mos vendosni asgjë mbi pajisje.
- Gjatë përdorimit, del avull i nxehtë nga vrimat e daljes së ajrit. Mbajini duart dhe fytyrën në distancë të sigurt larg avullit dhe vrimave të daljes së ajrit
- Pajisja është e pajisur me xham të temperuar, nëse xhami është dëmtuar mos e përdorni më tej pajisjen dhe kontaktoni një qendër shërbimi pranë jush.
- Mbajeni kordonin elektrik larg sipërfaqeve të nxehta.
- Aksesoret mund të nxehen gjatë dhe pas përdorimit të pajisjes - manovrojeni gjithmonë me kujdes.
- Kini kujdes nga avulli i nxehtë që del nga pajisja gjatë gatimit, në modalitetin e mbajtjes ngrohtë ose kur hapni kapakun. Kur kontrolloni ushqimin, përdorni gjithmonë mjete kuzhine me doreza të gjata.
- Mos e përdorni pajisjen për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përshkruar në këtë manual dhe përdorni vetëm aksesore origjinale të Philips.
- Mos përdorni kurrë aksesore apo pjesë nga prodhues të tjetër apo që nuk rekomandohen konkretisht nga Philips. Nëse përdorni aksesore apo pjesë të tilla, garancia juaj bëhet e pavlefshme.
- Gjithmonë përdorni aksesoren e dedikuar për të përgatitur ushqimin tuaj. Mos e vendosni kurrë ushqimin në kontakt të drejtpërdrejtë me gjeneratorin e avullit në pjesën e poshtme.
- Mos e lini pajisjen të funksionojë pa mbikëqyrje, gjithmonë sigurohuni që të jeni në kontroll të pajisjes tuaj.
- Gjithmonë përdoreni pajisjen me kapak të mbyllur siç duhet.
- Nëse përdorni funksionin "sous vide", sigurohuni të përdorni vetëm qese "sous vide" me cilësi të lartë.
- Përdoreni funksionin "sous vide" të pajisjes vetëm nëse përdorni qese "sous vide", përndryshe qeset "sous vide" mund të shkrijnë.
- Funksioni "sous vide" me temperatura nën 50°C nuk rekomandohet pasi mund të provokojë zhvillimin e baktereve.
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë materialeve që marrin flakë, si për shembull mbulesë tavoline ose perde.
- Përpara se ta përdorni pajisjen për herë të parë dhe pas çdo përdorimi, pastrojini mirë pjesët që bien në kontakt me ushqimin. Referojuni udhëzimeve në manual.
- Mos e gatuani kurrë me avull mishin e ngrirë, shpezët e ngrira apo prodhimet e ngrira të detit. Gjithnjë shkrijini këta ingredientë plotësisht përpara se t'i gatuani me avull.
- Sipërfaqet e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.
- Kjo pajisje është projektuar për t'u përdorur në temperaturë ambienti midis 10°C dhe 40°C.

Kujdes

- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim të zakonshëm në shtëpi. Ajo nuk është menduar për përdorim në ambiente si kuzhinat profesionale apo dyqane, zyra, ferma ose ambiente të tjera pune. Ajo as nuk është menduar për përdorim nga klientët në hotele, motele, ambiente për fjetje dhe mëngjes dhe mjedise të tjera banimi.
- Shkëputeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse e lini të pamonitoruar dhe përpara se ta montoni, çmontoni, ta vendosni në ruajtje ose përpara se ta pastroni atë.
- Mos e lëvizni pajisjen me avull kur është duke punuar.
- Gjithmonë dërgojeni pajisjen në pikë servisi të autorizuar nga Philips për kontroll ose riparim. Mos tentoni ta riparoni vetë pajisjen, përndryshe garancia bëhet e pavlefshme.
- Përdorni ujë vetëm në depozitën e ujit.
- Lëreni pajisjen të ftohet për rreth 30 minuta përpara se ta përdorni apo ta pastroni atë.
- Vendoseni pajisjen në një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale dhe të njëtrajtshme dhe sigurohuni që të ketë të paktën 10 cm hapësirë të lirë rreth saj për të parandaluar mbinxhjen.
- Mos përdorni folenë e pajisjes si depo, përveç aksesorëve të përshtatshëm.
- Temperatura, lagështia dhe koha ndryshojnë në bazë të llojit dhe sasisë së ushqimit që keni vendosur në pajisje.
- Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme apo për qëllime profesionale ose gjysmë-profesionale apo nuk përdoret sipas udhëzimeve në këtë manual përdorimi, garancia bëhet e pavlefshme dhe "Philips" refuzon çdo lloj përgjegjësie për dëmin e shkaktuar.
- Për të mbushur, rimbushur ose zbrazur depozitën e ujit, hiqeni nga pajisja. Mos e anoni pajisjen e plotë për të zbrazur depozitën e ujit.
- Nëse lëngjet duhet të hiqen nga foleja e gatimit përdorni një sfungjer ose diçka të ngjashme. Mos e anoni pajisjen për ta zbrazur.
- Meqë ushqimet ndryshojnë nga origjina, madhësia dhe marka, sigurohuni që ato janë gatuar mjaftueshëm përpara se t'i servirni.
- Mos e ringrini ushqimin pasi të ketë shkrirë.
- Mos përdorni acide acetike për pastrimin e smërçit.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Pajisja Philips është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Fikja automatike

Friteza me ajër është e pajisur me një funksion fikjeje automatike. Kur pajisja ndizet por nuk është në modalitetin e gatimit ose të mbajtjes ngrohët, do të kalojë në modalitet pasiv pas 20 minutash mosveprimi nga përdoruesi. Për ta fikur manualisht pajisjen, shtypni gjatë butonin rrotullues.

Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips!

Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në faqen **www.philips.com/welcome**.


Friteza me ajër Philips përdor teknologji NutriFlavor për të krijuar klimë optimale të qarkullimit të ajrit të nxehtë dhe lagështirë për ta gatuar çdo ushqim unik në perfeksion. Perime krokante, peshq të lëngshëm, mish i butë, pjekje të buta me deri në 90% ruajtje të lëndëve ushqyese*. Zbuloni gëzimin e krijimit të gatimeve të shijshme me prekjen e një butoni.

Për më shumë frymëzim, receta dhe informacion për Air Cooker, vizitoni **www.philips.com/welcome** ose shkarkoni programin falas NutriU App** për IOS® ose Android™.

* Provuar me brokoli, specat për mbushje, bizelet për 90% vitaminë C, në salmon për 93% omega 3/6 dhe mish viçi për 90% hekur. Matjet laboratorike në cilësimin Air Steam.

** Programi NutriU mund të mos ofrohet në vendin tuaj. Në këtë rast, jeni të lutur të hapni faqen vendore të internetit të Philips për frymëzim.

Shikim i përgjithshëm




1. Kapaku i qelqit
2. Rrjeti i qarkullimit të ajrit të nxehtë
3. Foleja e gatimit
4. Butoni rrotullues
5. Ekrani
6. Dalja e avullit
7. Butoni i lirimit të kapakut
8. Depozita e ujit dhe kapaku
9. Shtresa e dytë (shitet veçmas)
10. Koshi
11. Tenxherja e gatimit (për disa modele)
12. Kaseta e poshtme dhe rrjeta

Përshkrimi i funksioneve


Depozita e ujit

Friteza me ajër është e pajisur me një depozitë uji që ndodhet nga mbrapa pajisjes. Niveli i ujit MAX është rreth 600 ml. Treguesi i nivelit të ujit MAX është në anën e dorezës së depozitës së ujit dhe nuk duhet tejkaluar. Për të evituar grumbullimin e gëlqeres, zbrazeni depozitën pas çdo cikli gatimi.




Butoni rrotullues

Shtypni butonin rrotullues për të ndezur pajisjes, shtypni e mbani butonin rrotullues për të fikur pajisjen. Pasi pajisja të jetë ndezur, shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar një veprim. Rrotulloni butonin rrotullues për të kaluar nëpër opsione të ndryshme të menysë ose për të ndryshuar cilësimin e gatimit.



Kapaku i qelqit

Shtypni butonin e lirimit të kapakut për të hapur kapakun e qelqit. Kapaku hapet automatikisht.




Paralajmërim

- Sipërfaqja e kapakut të qelqit mund të nxehet gjatë përdorimit.

Caktimi i temperaturës

Disa metoda gatimi të ofruara kanë një cilësim të paracaktuar të rekomanduar të temperaturës, i cili nuk mund të rregullohet pasi një temperaturë e ndryshme mund të ndikojë në rezultatin e gatimit. Për të ndryshuar temperaturën e gatimit, përdorni modalitetin manual (shih kapitullin "Modalitetet e gatimit").



Përcaktimi i lagështisë

Disa metoda gatimi të ofruara kanë një cilësim të paracaktuar të rekomanduar të lagështisë, i cili nuk mund të rregullohet pasi një lagështi e ndryshme mund të ndikojë në rezultatin e gatimit. Për të ndryshuar cilësimin e lagështisë, përdorni modalitetin manual (shih kapitullin "Modalitetet e gatimit").



Tri nivele lagështie

	Përshkrimi	Përdoret në metodën e gatimit
	Lagështia joaktive	Pjekje
	Lagështia mesatare	Shihni recetat në programin NutriU. Ofrohet gjithashtu në modalitetin manual
	Lagështia e lartë	Avull, avullim me ajër, gatim i ngadaltë, shkrire, ringrohje, sous-vide

Koha e gatimit


Në modalitetin "manual" mund të vendosni kohën e gatimit nga 1 minutë në 60 minuta.

Në modalitetin "metodat e gatimit", mund ta vendosni

kohën e gatimit në një interval fiks. Shihni tabelën në kapitullin "Mënyrat e gatimit → Metodat e gatimit".

Të gjitha metodat e gatimit kanë një kohë gatimi të paracaktuar, e cila mund të rregullohet në bazë të sasisë së ushqimit që vendosni në pajisje ose rezultatit të gatimit që preferoni.

Mund të gjeni disa kohë të sugjeruara gatimi për lloje të ndryshme ushqimesh në kapitullin "Mënyrat e gatimit → përbërësit".



Zëri

Zhurma e pajisjes

Mund të dëgjoni një zhurmë të vogël ndërsa pajisja është duke punuar. Kjo është normale.

Zhurma vjen nga pompa, e cila e dërgon ujin përmes sistemit të brendshëm, dhe gjithashtu nga ventilatori, i cili gjeneron rrjedhën e ajrit në pajisje.

Njoftimet zanore

Ndonjëherë dëgjoni një tingull, për shembull kur pajisja ka përfunduar gatimin, ose kur kërkohet një veprim gjatë gatimit, p.sh., futja e një përbërësi tjetër në fritezën me ajër.


Ngrohja paraprake

Disa metoda gatimi si pjekja dhe pjekja kërkojnë ngrohje paraprake.

Njoftimi për ngrohjen paraprake shfaqet automatikisht në modalitetet e gatimit që kërkojnë ngrohje paraprake.

Nëse friteza me ajër tashmë është ngrohur pasi sapo keni gatuar diçka, mund ta anashkaloni ngrohjen paraprake dhe të filloni gatimin menjëherë.

Kohëmatësi i parangrohjes është vendosur në pesë minuta dhe nuk mund të rregullohet.



E rëndësishme

- Për të arritur rezultatin optimal të gatimit, vendoseni ushqimin në fritezën me ajër pasi të ketë përfunduar ngrohja paraprake.

Asistenti i tekstit

Të gjitha ekranet e menysë vijnë me një asistent teksti, i cili ju ndihmon të lëvizni nëpër meny. Përshkrimi i tekstit zhduket pas 10 sekondash dhe shfaqet përsëri kur futni një faqe tjetër në meny.

Përpara përdorimit të parë

E rëndësishme


- Gjatë përdorimit të parë, friteza me ajër mund të lëshojë pak tym dhe erë. Kjo duhet të shpërhapet brenda pak minutash. Përpara se të filloni të gatuar me të, përdoreni pajisjen bosh për rreth 30 minuta në 160°C me lagështinë joaktive dhe mbajeni ambientin të ajrosur.
1. Hiqni të gjithë materialin e paketimit.
 2. Hiqni çdo ngjitëse ose etiketë (nëse ka) nga pajisja.
 3. Pastrojeni plotësisht pajisjen përpara përdorimit të parë duke fshirë dhomën e gatimit me një leckë të lagur jogërryese. Shpëlajini aksesoret dhe pjesët e heqshme nën ujë të ngrohtë.

Lidhja e fritezës me ajër me programin NutriU


E rëndësishme

- Sigurohuni që pajisja juaj inteligjente të jetë e lidhur me rrjetin WiFi në shtëpi përpara se të filloni procesin e konfigurimit të WiFi.

1. Futeni pajisjen në prizë.




2. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur pajisjen.



Shënim


- Kur ndizni pajisjen për herë të parë, do t'ju kërkohet të zgjidhni gjuhën që dëshironi të përdorni për të lëvizur nëpër meny.

3. Lëvizni nëpër listë derisa gjuha që preferoni të theksohet.




4. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar përzgjedhjen e gjuhës.

- Shfaqet një ekran mirëseardhjeje.



5. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar dhe për të vazhduar.



Shënim

- Në ekranin tjetër mund të vendosni nëse ta lidhni pajisjen me pajisjen inteligjente menjëherë ose ta bëni më vonë.

6. Nëse vendosni të lidheni menjëherë, kaloni tek opsioni "Yes, please".

Shënim

- Ju rekomandojmë të shkarkoni programin NutriU dhe të shtoni "Air Cooker" në program sapo të konfiguroni pajisjen tuaj për herë të parë. Kjo ju mundëson të përdorni fritezën me ajër në maksimumin e vet, për shembull, për të kryer gatim në distancë dhe për të marrë njoftime për ecurinë e gatimit.

7. Shfaqet një kod QR. Skanojeni për të shkarkuar programin NutriU.

Këshillë

- Programin NutriU mund ta shkarkoni dhe nga App Store ose nga faqja e internetit **www.philips.com/NutriU**. Përndryshe, mund të skanoni kodin QR në broshurën që vjen në paketimin e fritezës me ajër.



8. Hapni programin NutriU dhe ndiqni procesin e regjistrimit.
9. Ndiqni hapat në program për ta lidhur fritezën me ajër me WiFi dhe për ta çiftuar fritezën me pajisjen tuaj inteligjente.

Shënim

- Nëse vendosni të lidhni më vonë fritezën me ajër, mund të filloni procesin e konfigurimit të WiFi te "Tools → Settings → setup WiFi" në menynë e fritezës me ajër.
- Mund ta përdorni fritezën me ajër me programin vetëm kur treguesi WiFi pranë ekranit është i bardhë i patejdukshëm.

Treguesi WiFi ka dy gjendje.

Treguesi WiFi është i fikur.	Wi-Fi është joaktive.
Treguesi WiFi është i ndezur.	WiFi është aktiv dhe i lidhur me ruterin.



E rëndësishme

- **Telekomanda:** mund ta kontrolloni nga distanca fritezën me ajër përmes programit (p.sh. të dërgoni një recetë, të ndaloni gatimin, etj.) vetëm nëse keni çzgjedhur "remote consent" në programin NutriU, që gjendet në profilin tuaj të NutriU.
- Sigurohuni që ta lidhni fritezën me ajër me një rrjet WiFi shtëpie 2,4 GHz 802.11 b/g/n.
- Çiftimi i një përdoruesi: Friteza me ajër mund të kontrollohet në distancë nga vetëm një përdorues në të njëjtën kohë. Nëse një përdorues i dytë dëshiron të kontrollojë fritezën me ajër dhe të përdorë programin NutriU, ky përdorues duhet të ndjekë procesin e çiftimit. Pasi të çiftohet, përdoruesi i parë do të çiftohet automatikisht.
- Procesi i konfigurimit të WiFi mund të anulohet nëpërmjet programit ose duke e hequr fritezën me ajër nga priza.

Shënim

- Mund ta aktivizoni ose çaktivizoni WiFi te "Tools → Settings → WiFi Setup".
- Mund ta rivendosni WiFi tek "Tools → Settings → WiFi Setup".

Përgatitja për përdorim

1. Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale, të rrafshët dhe rezistente ndaj nxehtësisë.

Paralajmërim


- Mos vendosni asgjë sipër ose në anët e pajisjes. Kjo mund të prishë rrjedhën e ajrit dhe të ndikojë në rezultatin e gatimit.
- Mos e vendosni pajisjen e ndezur pranë apo poshtë objekteve që mund të dëmtohen nga avulli, si muret dhe dollapët.

Shënim


- Gjithmonë vendosni shportën me tabakanë në pajisje. Mos e përdorni shportën vetëm.

Përdorimi i fritezës me ajër

1. Futeni fritezën me ajër në prizë.




2. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur fritezën me ajër.




3. Mbushni depozitën e ujit.

3a. Shkëputni depozitën e ujit nga pjesa e pasme e fritezës me ajër dhe hapni kapakun e depozitës të ujit.




3b. Mbushen me ujë deri në treguesin MAX.



Shënim

- Treguesi i nivelit të ujit MAX është në anën e dorezës së depozitës së ujit dhe nuk duhet tejkaluar.

3c. Vendoseni kapakun e depozitës të ujit përsëri në depozitë dhe lidheni në fritezën me ajër.




Shënim

- Sasia e ujit që nevojitet për gatim varet nga lloji i ushqimit dhe kohëzgjatja e gatimit, mund t'ju duhet të rimbushni depozitën e ujit gjatë gatimit. Një tregues i nivelit të ulët të ujit do të shfaqet në shiritin e gjendjes së gatimit në programin NutriU si dhe në ekranin e pajisjes.


4. Vendoseni ushqimin në fritezën me ajër.

Shënim


- Metodat e gatimit "Bake" dhe "Roast" kërkojnë ngrohje paraprake. Vendoseni ushqimin në pajisje pasi të ketë përfunduar ngrohja paraprake.



5. Zgjidhni mënyrën e gatimit që dëshironi të përdorni (shih gjithashtu kapitullin "Mënyrat e gatimit").



6. Vendosni parametrat e gatimit nëse është e nevojshme.
7. Shtypni butonin rrotullues për të filluar gatimin.



8. Fillon procesi i gatimit. Ndizet gjeneratori i avullit dhe ventilatori.

Shënim

- Kur ndaloni procesin e gatimit, për shembull për të rregulluar parametrat e gatimit ndërmjet gatimit, shtypni butonin rrotullues për ta bërë këtë. Shtypni përsëri butonin rrotullues për të rifilluar gatimin.
- Mos e vendosni fritezën me ajër pranë një pajisjeje tjetër gatimi, afër murit të kuzhinës ose poshtë dollapit të kuzhinës, pasi avulli i nxehtë mund të kondensohet dhe të rrjedhë nëpër sipërfaqe.

Paralajmërim

- **Gjatë përdorimit, del avull i nxehtë nga vrimat e daljes së ajrit. Mbani duart dhe fytyrën në distancë të sigurt larg avullit dhe vrimave të daljes së ajrit.**

9. Kur të kalojë koha e gatimit, do të shihni ekranin "Enjoy".
- Do të tingëllojë një melodi.
10. Mund të ktheheni në menynë kryesore (kaloni tek ikona x dhe konfirmoni), ta mbani ushqimin të ngrohtë ose të gatuar plotësisht përpara se ta shërbeni.

Shënim

- Zbrazni depozitën e ujit kur të keni mbaruar gatimin.
- Gjithmonë sigurohuni që ushqimi juaj të jetë gatuar plotësisht përpara se ta shërbeni.

Mënyrat e gatimit

	Mode (Modaliteti)		Mënyrat	Niveli i aftësive të përdoruesit të fritezës me ajër
1	Gatim i udhëzuar me recetë		Zgjidhni një recetë në program dhe dërgojeni te friteza me ajër.	Gatim i automatizuar i të gjitha niveleve: udhëzim i plotë
2	Përbërësit		Zgjidhni përbërësit, më pas mënyrën e gatimit. Friteza me ajër rregullon automatikisht temperaturën dhe lagështinë. Rregulloni bazën e kohës sipas rezultatit përfundimtar të preferuar dhe filloni gatimin.	Fillestar: udhëzim i plotë
3	Metodat e gatimit		Zgjidhni mënyrën e gatimit. Friteza me ajër rregullon automatikisht temperaturën dhe lagështinë. Rregulloni bazën e kohës sipas rezultatit përfundimtar të preferuar dhe filloni gatimin.	I avancuar: udhëzim bazë
4	Modaliteti manual		Rregulloni manualisht kohën, temperaturën dhe lagështinë dhe filloni gatimin.	Ekspert: nuk ka udhëzime


Gatim i udhëzuar me recetë përmes programit NutriU

Nëse jeni përdorues fillestar i fritezës me ajër, ju rekomandojmë të përdorni modalitetin e gatimit të udhëzuar me recetë. Është mënyra më e lehtë për t'u njohur me fritezën me ajër. Nëse jeni përdorues më me përvojë, programi NutriU ju ndihmon të arrini potencialin e plotë të fritezës me ajër.


Shënim

- Gatimi i udhëzuar me recetë është i mundur vetëm kur friteza me ajër dhe pajisja juaj inteligjente janë të lidhura, çiftuara dhe pëlqimi në distancë është dhënë në profilin tuaj të NutriU.

- Futeni fritezën me ajër në prizë.



2. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur fritezën me ajër.



3. Hapni programin NutriU në pajisjen tuaj inteligjente dhe zgjidhni një recetë në programin NutriU.
4. Shtypni "Get started".
 - Cilësimi përkatës shfaqet në programin NutriU dhe gjithashtu pasqyrohet në pajisjen tuaj.
5. Rregulloni kohën nëse është e nevojshme dhe më pas filloni gatimin nga programi ose nga pajisja.

Këshillë

- Nëse i përmbaheni rreptësisht recetës për sa i përket përbërësve dhe sasisë së ushqimit, nuk keni nevojë të rregulloni kohën e gatimit.
- Nëse gatuani më pak ose më shumë se sasia e rekomanduar e ushqimit në recetë, mund t'ju duhet të rregulloni kohën e gatimit në përputhje me rrethanat.

Shënim

- Ju gjithashtu mund të ndryshoni parametrat e gatimit si "humidity" dhe "temperature" për një recetë. Ndryshimi i këtyre parametrave mund të ndikojë në rezultatin e gatimit.

Modaliteti "Ingredients"

Gatuani me këtë modalitet nëse jeni një përdorues fillestar i fritezës me ajër dhe dëshironi të keni udhëzime të plota mbi procesin e gatimit.


E rëndësishme

- Kur hyni në listën e përbërësve për herë të parë, domethënë përpara se të lidhni fritezën me ajër me WiFi të shtëpisë tuaj, ka vetëm një listë të parazgjedhur përbërësish. Lista do të përditësohet automatikisht sapo të lidhni dhe çiftoni fritezën me ajër me pajisjen tuaj inteligjente sipas shtetit/rajonit që zgjidhni gjatë procesit të lidhjes në program.


Shënim

- Herë pas here lista e përbërësve përditësohet automatikisht. Kjo kërkon që friteza me ajër të jetë e lidhur me WiFi a shtëpisë.



1. Futeni fritezën me ajër në prizë.




2. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur fritezën me ajër.




3. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet **Ingredients**.




4. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar.




5. Rrotulloni butonin rrotullues për të zgjedhur përbërësin që dëshironi të gatvani. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar.



6. Zgjidhni një nga metodat e rekomanduara të gatimit dhe konfirmoni.



7. Shtypni butonin rrotullues për të filluar gatimin.



Shënim

- Koha e paracaktuar e gatimit bazohet në sasinë e përbërësve që vendosni në fritezën me ajër.

Shihni tabelën më poshtë për sasinë e sugjeruar të ushqimit sipas kohës së paracaktuar të gatimit.

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Metodat	Temperatura e gatimit	Lagështia e gatimit	Koha e gatimit	Ngrohja paraprake
Perime	Spinaq	250g	Avull	100°C		10 min	jo
	Brokoli	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
		600g	Rosto	160°C		13 min	po
	Kungulleshka	500g	Gatimi me avull në ajër	120°C		15 min	jo
	Lulelakër	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		15 min	jo
		600g	Rosto	160°C		20 min	po
	Fasule të gjelbra	500g	Gatimi me avull në ajër	120°C		17 min	jo

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Metodat	Temperatura e gatimit	Lagështia e gatimit	Koha e gatimit	Ngrohja paraprake
	Patëllxhan	750g	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
		680g	Rosto	160°C		20 min	po
	Lakra Brukseli	500g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Shparg i gjelbër	750g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Spec për mbushje	500g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Domate	750g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
Perime me rrënjë dhe niseshte	Patate të plota	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		40 min	jo
	Patate të prera në katër pjesë	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		35 min	jo
		600g	Rosto	160°C		45 min	po
	Patate e ëmbël portokalli e prerë katërsh	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		20 min	jo
	Patate e ëmbël e plotë	600g	Rosto	160°C		30 min	po
	Kubikë kungulli	750g	Gatimi me avull në ajër	120°C		30 min	jo
		750g	Rosto	160°C		30 min	po
	Karota	750g	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
		750g	Rosto	160°C		25 min	po
Drithëra	Oriz Basmati	200 g oriz/ 550 ml ujë	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
	Oriz Jasmin	200g/ 550ml	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
	Oriz i gjatë kokërrplotë	200g/ 550ml	Gatimi me avull në ajër	120°C		40 min	jo

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Metodat	Temperatura e gatimit	Lagështia e gatimit	Koha e gatimit	Ngrohja paraprake
	Mel	200g/400ml	Gatimi me avull në ajër	120°C		20 min	jo
	Kuinoa	200 g/550ml ujë	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
	Elb	200g/600ml	Gatimi me avull në ajër	120°C		40 min	jo
	Hikërr	200g/450ml	Gatimi me avull në ajër	120°C		20 min	jo
	Kuskus/bollgur	200 g/300 ml ujë	Gatimi me avull në ajër	120°C		10 min	jo
Mish	feta viçi pa dhjamë	1000g	Gatimi me avull në ajër	120°C		50 min	jo
	feta derri pa dhjamë	1000g	Gatimi me avull në ajër	120°C		60 min	jo
	Derr me vija	1000g	Rosto	160°C		60 min	po
	Brinjë derri	1000g	Rosto	160°C		60 min	po
Shpesë	Gjoks pule	550 g (3 copë)	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
		550g	Rosto	160°C		25 min	po
	Gjoks gjeldeti	550g	Gatimi me avull në ajër	120°C		25 min	jo
		550g	Rosto	160°C		25 min	po
	Pulë e plotë	1450g	Rosto	160°C		60 min	po
	Kofshë pule	400g	Rosto	160°C		50 min	po
	Gjoks rose	600 g (2 copë)	Rosto	160°C		12 min	po
Peshk dhe ushqime deti	Salmon	450g	Gatimi me avull në ajër	120°C		15 min	jo
		450g	Rosto	160°C		20 min	po
	Levrek	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Karkaleca	800g	Gatimi me avull në ajër	120°C		15 min	jo

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Metodat	Temperatura e gatimit	Lagështia e gatimit	Koha e gatimit	Ngrohja paraprake
	Troftë	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Kallamar	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		15 min	jo
	Filetë peshku të bardhë	600g	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
Vezë	Vezë e zier mirë	560 g/ 10 vezë	Gatimi me avull në ajër	120°C		12 min	jo
	Vezë e zier lehtë	560 g/ 10 vezë	Gatimi me avull në ajër	120°C		8 min	jo

Shënim

- Për çdo përbërës ka edhe një recetë NutriU. Shihni programin për më shumë informacion.
- Nëse koha e paracaktuar e gatimit nuk çon në rezultatin e pritur të gatimit pasi keni gatuar më shumë ose më pak se sasia e rekomanduar e ushqimit, rregulloni kohën e gatimit në përputhje me rrethanat.

Modaliteti “cooking method”

Ky modalitet rekomandohet kur jeni tashmë pak të njohur me gatimin me fritezën me ajër. Mund të zgjidhni mënyra të ndryshme gatimi.

Metoda e gatimit	Caktimi i temperaturës	Përcaktimi i lagështisë	Koha e paracaktuar	Diapazoni	Shembuj
Gatimi me avull në ajër	120°C		10 min	1–90 min	Perime, mish, peshk, ushqim deti, gatime me vezë
Avull	100°C		10 min	1–90 min	Perime me gjethe, petulla, ravioli të freskëta
Rosto	160°C		50 min (plus 5 minuta parangrohje)	1–90 min	Mish, shpendë, peshk, perime, patate
Pjekje	160°C		35 min (plus 5 minuta parangrohje)	1–90 min	Gratin, lazanja, ëmbëlsira, kekë të vegjël, role buke
Gatim i ngadaltë	80°C		120 min	1–180 min	Mish, zierje, supa, salca
Sous-vide	50°- 90°C		90 min	1–180 min	Mish, shpendë, peshk, ushqim deti
Shkrijja	60°C		20 min	1–180 min	Lloje të ndryshme ushqimi të ngrirë
Ringrohje	120°C		15 min	1–90 min	Lloje të ndryshme mbetjesh

Shënim

- Disa metoda gatimi si pjekja dhe pjekja kërkojnë ngrohje paraprake.
- Nëse friteza me ajër tashmë është ngrohur pasi sapo keni gatuar diçka, mund ta anashkaloni ngrohjen paraprake dhe të filloni gatimin menjëherë.
- Kohëmatësi i parangrohjes është vendosur në pesë minuta dhe nuk mund të rregullohet.

Paralajmërim

- **Gjatë përdorimit, del avull i nxehtë nga vrimat e daljes së ajrit. Mbani duart dhe fytyrën në distancë të sigurt larg avullit dhe vrimave të daljes së ajrit.**
- **Kini kujdes nga avulli i nxehtë që del nga pajisja gjatë gatimit, në modalitetin e mbajtjes ngrohtë ose kur hapni kapakun.**
- **Kur kontrolloni ushqimin, përdorni gjithmonë mjete kuzhine me doreza të gjata.**
- **Mos e gatuani kurrë me avull mishin e ngrirë, shpezët e ngrira apo prodhimet e ngrira të detit. Gjithnjë shkrijini këta ingredientë plotësisht përpara se t'i gatuani me avull.**

Gatimi me avull në ajër

Ne rekomandojmë përdorimin e "Air Steam" për të gjitha llojet e perimeve, mish pa dhjamë, peshk, ushqim deti dhe të gjitha llojet e drithërave. Ky cilësim ruan shijen natyrale, strukturën dhe ngjyrën e ndritshme të ushqimit tuaj.

Koha e gatimit e dhënë në tabelë është udhëzuese për përbërësit e freskët. Nëse koha e gatimit nuk çon në rezultatin e pritur të gatimit, rregulloni kohën e gatimit në përputhje me rrethanat.

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Koha e gatimit
Perime	Brokoli	600g	12 min
	Kungulleshka	500g	15 min
	Lulelakër	600g	15 min
	Fasule të gjelbra	500g	17 min
	Lakra Brukseli	500g	12 min
	Shparg i gjelbër	750g	12 min
	Spec për mbushje	500g	12 min
	Domate	750g	12 min
	Patëllxhan	750g	25 min
Perime me rrënjë dhe niseshte	Patate të plota	600g	40 min
	Patate e prerë katërs	600g	35 min
	Patate e ëmbël portokalli e prerë katërs	600g	20 min
	Kubikë kungulli	750g	30 min

Grupi i përbërësve	Përbërësi	Sasia	Koha e gatimit
	Karota	750g	25 min
Drithëra	Oriz Basmati	200 g oriz/550 ml ujë	25 min
	Oriz Jasmin	200g/550ml	25 min
	Oriz i gjatë kokërrplotë	200g/550ml	40 min
	Mel	200g/400ml	20 min
	Kuinoa	200 g/550ml ujë	25 min
	Elb	200g/600ml	40 min
	hikërr	200g/450ml	20 min
	Kuskus/bollgur	200 g/300 ml ujë	10 min
Mish	feta viçi pa dhjamë (filetë viçi)	1000g	50 min
	feta derri pa dhjamë	1000g	60 min
